

**TRASHËGIMIA SOCIO-KULTURORE DHE VLERAT IDENTITARE TË
RAJONIT TË RUGOVËS**

**TEMA PËR TITULLIN
DOKTOR I SOCIOLOGJISË**

NGA

DARDAN LAJÇI



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË**

Mentor: Prof. asoc. dr. Ibrahim Berisha

**PRISHTINË
Shkurt, 2022**

REZYME E PUNIMIT TË DOKTORATËS

“Trashëgimia socio-kulturore dhe vlerat identitare të rajonit të Rugovës”

Rugova është një tërësi gjeografike, një vend malor me 14 fshatra, që shtrihet në vargmalet e Alpeve Shqiptare në perëndim të qytetit të Pejës, përgjatë dy anëve të Lumbardhit të Pejës. Veçoritë e theksuara të natyrës shoqërore e ekonomike paraqesin një tërësi të dalluar socio-kulturore, në këtë kontekst po aq sa etnologjike ashtu edhe etnografike. Gjithashtu, relievi, kushtet klimatike, ujërat, pyjet bëjnë që kjo zonë të veçohet si tërësi me resurse të bollshme natyrore dhe kulturore. Rugova shquhet për një sërë pasurish karakteristike, sa me fond të gjerë të botës bimore e shtazore po ashtu edhe me vlera të trashëgimisë kulturore. Në këtë kontekst duhet të veçohet thesari i këngëve kreshnike. Rugova është një konglomerat kompleks socio-fizik, pak i hulumtuar, veçanërisht trashëgimia kulturore, në këtë kontekst edhe tradita socio-urbane si dhe ajo arkeologjike. Megjithëkëtë, si vend turistik ajo tashmë është në një proces të thellë transformimi si dhe ky transformim është bërë posaçërisht mbas përfundimit të luftës së fundit. Rajoni i Rugovës në gjirin e tij ka pasuri natyrore, si: pemë të egra, pyje, liqene, faunë dhe florë të pasur, turizëm, vlera kulturoro-materiale dhe jomateriale, të cilat janë të jashtëzakonshme. Veçmas është i njohur në fushën e eposit, me toponimi, histori të hershme të njerëzve luftarak etj. Tradita e kësaj treve është e hershme. Zhvillimin shoqëror, në periudha të ndryshme, e karakterizojnë procese që kanë ndodhur, e veçanërisht hetohen ato në kulturë. Krijimtaria materiale dhe jomateriale vërtetohet se ekziston që nga antikiteti duke e ruajtur dinamikën e kultivimit në vazhdimësi që kryesisht shprehet në shtresimet shoqërore që mbërrin deri në ditët e sotme. Të dhënat historiografike, strukturat arkitektonike, fortifikimet, objektet e kultit, eposi i kreshnikëve, artefaktet, ushqimi, zakonet, normat, lojërat tradicionale të Rugovës, shalli i burrave rugovas, veshja, besimi fetar, lahuta si instrument tejet i veçantë tregojnë për një qasje studimore njohëse të kësaj treve si një mundësi të madhe të kërkimeve dhe të rezultateve të reja shkencore që mund të japin këto hulumtime. Banorët e Rugovës shquhen për ruajtjen e traditave të hershme të mikpritjes, besës dhe nderit, e quajnë veten *malësor* dhe në vështrim të së drejtës zakonore mbahen me Kanunin e Maleve. Veçojmë disa elemente identitare si: Ndjenja e përkatësisë, toka, gjuha, historia, tradita, të cilat në vazhdimësi kanë qenë në funksion të ruajtjes së identiteti social, kulturor e kombëtar të banorëve të këtij rajoni. *Fjalë kyçe: Identitet, kulturë, rajon, Rugovë, traditë, turizëm, vlerë.*

Duke përdorur burime të metodologjisë së avancuar sociologjike, burime të botuara të bollshme, literaturë relevante, kandidati Dardan Lajçi po prezenton këtë rezymë të disertacionit të Doktoratës në mënyrë që ai të jetë më afër mbrojtjes së tezës, në aspektin kohor. Në aspektin strukturor, teza e doktoratës është e ndarë në katër kapituj dhe në disa nënkapituj të cilëve u paraprin hyrja ku ai shpjegon qëllimet dhe metodat të cilat do të përdorë për realizimin e punimit. Kapitujt në vijim kanë këtë përmbajtje strukturore: **Në kapitullin e parë** trajton trashëgiminë dhe identitetin, dy karakteristika të kulturës, teoritë për kulturën dhe identitetin, të ngritura nga studiues të ndryshëm, si dhe ndërvarshmërinë e këtyre teorige në krahasim me trashëgiminë socio-kulturore shqiptare, respektivisht me kulturën e rajonit të Rugovës, pastaj konceptet dhe përkufizimet mbi trashëgiminë. Pjesa hyrëse e kapitullit të parë karakterizohet nga përshkrimi i përgjithshëm për rajonin e Rugovës, florës dhe faunës, popullsisë së Rugovës, migrimit të popullatës, strukturës dhe organizmit ekonomik të shoqërisë, fisit dhe bajrakut, fisit Kelmend, besës si fenomen socio-kulturor në Rugovë, identitetit social, kulturor, kombëtar nëpër periudha historike e bashkëkohore, transformimit të jetës dhe veprimtarisë së punës së komunitetit rugovas.

Në kapitullin e dytë trajtohen veçoritë socio-kulturore të trashëgimisë së fshatrave të rajonit të Rugovës, familja (forma e organizimit, etnogjeneza), toponimet, trashëgimia e emrave, religjioni, oda e burrave, kullat, malësorët, të *zhdjergat* etj.

Në kapitullin e tretë paraqiten traditat, zakonet, doket, ritualet, lindja, fejesa, martesat. Vlerat e trashëgimisë së kulturës tradicionale (Aspekte të krijimtarisë folklorike, këngët kreshnike, vallja e Rugovës unike, instrumentet muzikore, festat dhe ritualet, artizanatet, etj), veshja tradicionale rugovase, fejesa, kanaxheqi, dasma, Ansambli Folklorik Autokton “Rugova” (në vitin 2017 festoi 70-të vjetorin e themelimit), mbamendja për këngët kreshnike, lahutarët dikur dhe sot, e folmja e Rugovës, mjekësia tradicionale, lojërat tradicionale të Rugovës, pajtimi i gjaqeve dhe misioni i prof.dr. Anton Çettes; arsimi, figurat kulturore, intelektuale e kombëtare rugovase, shkolla fillore “Përparimi” në Drelaj.

Kapitullin i katërt i kushtohet zhvillimit të turizmit në funksion të ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë socio-kulturore si dhe ndikimit të tij në ngritjen socio-ekonomik të komunitetit rugovas, ekologjisë dhe mjedisit në Rugovë, ushqimit, mjekësisë tradicionale dhe monumenteve kulturore materiale. përgjithësisht turizmit kulturor që e ruan origjinalitetin e popullsisë lokale. Në fund janë pasqyruar të gjeturat e kërkimit nga terreni: pyetësorët, foto-ilustrimet, hartat etj.

Doctoral dissertation summary

“Socio-cultural heritage and identity values of the Rugova region”

Rugova is a geographical whole, a mountainous place with 14 villages, which lies in the mountains of the Albanian Alps west of the city of Peja, along the two sides of the river Lumbardh of Peja. The emphasized features of social and economic nature represent a distinct socio-cultural whole, in this context also ethnological and ethnographic. Also, the relief, climatic conditions, waters, forests make this area stand out as a whole with abundant natural and cultural resources. Rugova is known for a series of characteristic riches, both with a wide fund of flora and fauna and with cultural heritage values, especially the precious treasure of Kreshnik songs. Rugova is a complex socio-physical conglomerate, little researched, especially cultural heritage, in this context both socio-urban and archaeological traditions. However, as a tourist destination it is already in a deep process of transformation and this transformation took place separately after the end of the war (1999). The region of Rugova in its bay has natural resources such as: Wild trees, forests, lakes, rich fauna and flora, tourism, cultural material and intangible values, which are extraordinary. It is especially known in the field of epic, with toponyms, early stories of its warriors, etc. The tradition of this trio is early. Social development in different periods characterizes the processes that have taken place, and they are especially investigated in culture. Material and immaterial creativity is proven to have existed since antiquity while maintaining the dynamics of cultivation continuously that are also expressed in social additions and such reach to the present day. Historiographical data, architectural structures, fortifications, cult objects, epic of the Knights Templar, artifacts, customs, norms, traditional games of Rugova, scarf of Rugova men, clothing, religion, lahuta as a very special instrument show a very visual approach of this area as a great opportunity for research and new scientific results that can provide this research. The inhabitants of Rugova are known for preserving the early traditions of hospitality, faith and honor, they call themselves highlanders and in the view of customary law they are kept with the "Kanun of the Mountains". We single out some identity elements such as: sense of belonging, land, language, history, traditions, which have been continuously in order to preserve the social and cultural identity of the inhabitants of this region.

Keywords: Identity, Culture, region, Rugova, tradition, tourism, value.

Using sources of advanced sociological methodology, abundant published sources, relevant literature, candidate Dardan Lajçi is presenting this summary of the Doctoral dissertation so that it is closer to the defense of the thesis, in terms of time. In structural terms, the doctoral thesis is divided into four chapters and several sub-chapters which are preceded by an introduction where he explains the goals and methods which he will use to carry out the work. The following chapters have this structural content: ***In the first chapter*** deals with heritage and identity, two characteristics of culture, theories of culture and identity, developed by various scholars, and the interdependence of these theories in comparison with the Albanian socio-cultural heritage, respectively with the culture of the Rugova region, then the concepts and definitions on heritage. The introductory part of the first chapter is characterized by the general layout of the Rugova region, the description of the flora and fauna, the population of Rugova, the migration of the population, the structure and economic organism of the society, the tribe and the flag, the Kelmend tribe, faith as a socio-cultural phenomenon in Rugova, social, cultural, national identity through historical and contemporary periods, the transformation of life and work activity of the Rugova community. ***The second chapter*** deals with the socio-cultural features of the heritage of the villages of the Rugova region, family (form of organization, ethnogenesis), toponyms, heritage of names, religion, chamber of men, towers, highlanders, nomads, etc.

The third chapter presents traditions, customs, customs, rituals, births, engagements, marriages. The values of the heritage of traditional culture (Aspects of folklore creativity, heroic songs, unique Rugova dance, musical instruments, festivals and rituals, handicrafts, etc.), traditional Rugova dress, engagement, canning, wedding, Folk ensemble "Folk ensemble" in 2017 celebrated the 70th anniversary of its founding), the memory of the heroic songs, the lahutars then and today, Rugova's speech, traditional medicine, Rugova's traditional games, the reconciliation of bloodshed and the mission of prof.dr. Anton Çettes; education, cultural, intellectual and national figures of Rugova, primary school "Përparimi" in Drelaj.

The fourth chapter is dedicated to the development of tourism in order to preserve and develop the socio-cultural heritage and its impact on the socio-economic development of the Rugova community, ecology and environment in Rugova, food, traditional medicine and material cultural monuments. generally cultural tourism that preserves the originality of the local population. Finally, the field research findings are reflected: questionnaires, photo-illustrations, maps, etc.